



Prishtinë: 10.07.2026
Kodi i ZRRE-së: V_3285_2026

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, me A.nr. 495/2023 i dt. 26.03.2024;

në seancën e mbajtur më datë 10.07.2026, nxori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET** ankesa e konsumatorit **J. B.**, nga fshati Hajvali, rr. Preng Bib Doda, Komuna e Prishtinës, si e pabazuar.
 - II. MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2374_10_22, i datës 31.10.2022.
- I.** Vendimi nixirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
 - II.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Me datë 31.10.2022, Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve, pasi që e kishte shqyrtuar rastin e konsumatorit J. B., ka nxjerrë një Vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2374_10_22, me të cilin e ka refuzuar ankesën e konsumatorit si të pabazuar, përmes së cilës konsumatori e kishte kontestuar faturimin e kWh të grumbulluar me njehsorin elektrik të vendosur në mënyrë të paautorizuar nga vet konsumatori dhe në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

I pakënaqur me këtë vendim, konsumatori brenda afatit ligjor, ka parashtruar ankesë në Bordin e Zyrës së Rregullatorit për Energji, me kërkesën që të rishqyrtohet vendimi i kontestuar dhe fatura e muajit 06/2022, fatura e kontestuar, me arsyetimin se nuk është e drejte, si dhe, t'i mundësoj konsumatorit një kohëzgjatje me të madhe të pagesës.

Bordi i ZRrE-së, në seancën e mbajtur me dt. 27.01.2023, përmes Vendimit me nr. V_1672_2023, e ka refuzuar ankesën e konsumatorit si të pabazuar dhe në fuqi ka mbetur Vendimi i DMK-së i dt. 31.10.2022.

Ndaj këtij vendimi dhe brenda afateve ligjore, konsumatori/paditësi, ka iniciuar konflikt administrativ, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, me kërkesën për



anulimin e Vendimit të Bordit me nr. V_1672_2023, si dhe që lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Me datë 26.03.2024, Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, ka nxjerrë Aktgjykimin me shenjen A.nr. 495/2023, përmes së cilit, është aprovuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit si e bazuar, ashtu që është anuluar Vendimi me nr. V_1672_2023, i dt. 27.01.2023, dhe çështja është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura – ZRrE.

Ndër të tjera, gjykata e arsyeton vendimin e saj me faktin se, organi i paditur nuk e ka trajtuar pretendimin e paditësit sa i përket çështjes së parashkrimit të borxhit, dhe se, sipas kërkesave ligjore të LPPA-së, në riprocedurë duhet të marr parasysht të gjitha pretendimet ankimore të paditësit.

Ndaj këtij aktgjykimi, ZRrE brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Gjithsesi, me Aktgjykimin me shenjen AA.nr. 443/2024, i dt. 07.05.2026, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ZRrE-së dhe e ka vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore – Departamenti për Çështje Administrative.

Duke vepruar sipas obligimeve ligjore për zbatim të vendimit gjyqësor, në seancën e dt. 10.07.2026, Bordi i ZRrE-së e ka rishqyrtuar rastin e konsumatorit Jeton Berisha, lidhur me kontestimin e faturës së muajit 06/2022 dhe pas analizimit të dokumentacionit relevant lidhur me rastin, si dhe pas analizimit të vendimit të Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve, ka gjetur se ky vendim është vendim i drejtë dhe i ligjshëm dhe i bazuar në prova konkrete si në shkresat e lëndës, sepse:

Konsumatori ishte faturuar në muajin 06/2022, me kWh e grumbulluar, në njehsorin elektrik që e kishte vendosur në mënyrë të paautorizuar, pra pa aprovimin e OSSH-së dhe pas ankesës së konsumatorit në KESCO, i njëjti është korrigjuar, ashtu që, pas shpërndarjes së kWh për periudhën 02/2022 e deri me 05/2022 dhe se nga faturimi i tërësishëm, konsumatorit i janë zbritur -2,938.24 €. ZRrE e ka rivlerësuar këtë korrigjim, dhe ka gjetur se, konsumatorit nuk i takon korrigjim tjetër financiar. Gjithsesi, duke marrë parasysht që konsumatori kishte parashtruar kërkesa për LR që nga viti 2020, ZRrE e ka obliguar KESCO-n që për pjesën e mbetur të faturës së kWh të grumbulluar, t'i ofroj konsumatorit një kontratë pagese për periudhën kohore njëzet (20) mujore.

Për më tepër, edhe në ankesën e konsumatorit të dt. 23.09.2022, ndër të tjera, i njëjti kishte kërkuar që, pas rivlerësimit të borxhit nga Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve, t'i mundësohet pagesa me këste dhe atë në një afat sa më të gjatë kohor, dhe të mos detyrohet konsumatori që të bëjë fillimisht një pagesë të borxhit, në mënyrë që të jetë të gjendje të përballojë pjesën e shpenzimit të rregullt mujor si dhe këstit. Pra, edhe vet konsumatori e ka pranuar borxhin e energjisë elektrike, të krijuar nga veti ai, me rastin e vendosjes së njehsorit elektrik në mënyrë të paautorizuar, dhe duke marrë parasysht dokumentet relevante, si kërkesat e parashtruara për Lidhje të Re, ZRrE e ka obliguar KESCO-n që t'i ofrojë një kontratë pagese konsumatorit për periudhën kohore 20 mujore.

Ndërkaq, lidhur me çështjen kryesore të ngritur nga gjykata rreth institutit të parashkrimit, dhe faktit që i njëjti nuk është shqyrtuar si pretendim ankimor i ankuesit, prej vitesh ZRrE mban qëndrim që, parashkrimi si institut i së drejtës materiale, nuk trajtohet dhe nuk shqyrtohet në procedurë administrative dhe në nivel të organeve administrative, për shkak që, kjo çështje është në



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Adnan Preniqi, Anëtar



Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së;
- Konsumatorit **J. B.**, dhe,
- Arkivit të ZRRE-së.